



Pranuar / Doretuar Priljezi/Prodato Received/Delivered	08.11.2023	3	viti god year
Organ / Sheshtia Organ / Jednica Org / Unit	SKIMESHOK	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kohësia Quantity
Id. Prot Id. Prot Prot No	6941/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1286/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1286/2023 të datës 13.10.2023 të parashtruar nga ankuesja [REDACTED], me adresë rruga "Avni Rrustemi", Nr. 9, në Prishtinë, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1286/2023 e datës 13.10.2023 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED].

A r s y e t i m

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 05.05.2023 ka publikuar konkursin me Nr.Reference RN00011609 për grup "Specialit të Arsimit pozita Inspektor i Arsimit" në SIA Prishtinë, ku afati për aplikim ka qenë nga data 26.05.2023 deri më datë 05.06.2023. Në këtë konkurs në bazë të listës së kandidatëve ka aplikuar edhe ankuesja të cilës në bazë të Vendimit me Nr. 74/2023 të datës 10.07.2023 të zv. Udhëheqëses së Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit i është refuzuar aplikacioni për shkak që nuk ka ofruar licencë të mësimdhënësit, ndërsa kundër këtij vendimi ankuesja ka parashtruar ankesë, ndërsa zv. Udhëheqësja së Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, më datë 19.07.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 23/2023 përmes të cilit ka aprovuar ankesën e ankueses duke e ndryshuar/plotësuar listën e verifikimit paraprak me obligimin që e njëjta të përfshihet në listën e ngushtë dhe njoftohet për

proceduarat vijuese.

Më datë 10.08.2023 në orën 13:51 pasdite përmes emailit nga Sh.H, ankuesja përmes emailit të saj është njoftuar se testi me shkrim mbahet më datë 14.08.2023 nga orë 15:00, në ndërtesën e ish-Rilindjes kati përdhese salla nr. 015, ndërsa përmes përgjigjes në ankesë të datës 31.10.2023 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ka njoftuar që përveç emailit të dërguar pala ankuese në aplikacionin e saj nuk ka lënë numër telefoni.

Më datë 12.09.2023 është publikuar njoftimi për rezultatin përfundimtar lidhur me këtë procedurë të pranimit, ndërsa ankuesja më datë 13.10.2023 përmes ankesa.kpmschck@rks--gov.net, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6539/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.1286/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.10.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ndërsa, Këshilli më datë 31.10.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6539/2023 të datës 13.10.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 74/2023 të datës 10.07.2023 të zv. së Udhëheqëses së Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Ankesën e ankuese për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimin me Nr. 23/2023 të datës 19.07.2023 të zv. së Udhëheqëses së Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 31.10.2023; Konkursin me Nr.Reference RN00011609 për grup *Specialit të Arsimit pozita Inspektor i Arsimit* në SIA Prishtinë; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Njoftimin e datës 19.07.2023 të verifikimit paraprak; Vendimin me Nr. 05/151 të datës 12.07.2023 për emërimin e Komisionit të Pranimit; Emailin për testim me shkrim i datës 10.08.2023 nga Sh.H për ankuesen; Njoftimin e datës 12.09.2023; Aplikacionin e ankueses i darës 29.05.2023, Diplomën me Nr. 399/13, Diplomën me Nr. 442, Certifikatën 2016, Certifikatën tetor 2021, Vërtetim i përvojës së punës i datës 06.12.2022, Vërtetim e Nr. 127/2022 i datës 06.12.2022, Dokument identifikimi, Vlerësim në punë i datës 06.12.2022, Vërtetimin me Nr. 128/2022 i datës 06.12.2022, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 22.05.2023, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 098.06.2022-10.05.2023; Aplikacionin e kandidatit A.T, B.K-B, B.S, V.M, V.N, M.D, A.B-Zh, M.K, B.V, A.Sh, L.M, Sh.D, V.K, A.F, V.Th-B, F.R, R.B, I.B, Y.A, V.V-J, F.I, Y.V, D.Th, S.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e parakohshme, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se edhe pse më është aprovuar ankesa sipas Vendimit me Nr. 23/2023 të datës

19.07.2023 të zv. së Udhëheqëses së Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit nuk kam pranuar asnjë email dhe nuk jam ftuar në asnjë fazë të testimit me shkrim dhe nuk kam pranuar asnjë informatë deri më datë 29.09.2023 kur është shpallur rezultati përfundimtar i vlerësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës, konstaton se në bazë të Vendimit me Nr. 23/2023 të datës 19.07.2023 të zv. së Udhëheqëses së Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, ankueses i është aprovuar ankesa njëkohësisht është ndryshuar/plotësuar vendimi për listën e ngushtë dhe sipas këtij vendimi e njëjta është përfshirë në listën e ngushtë dhe njoftohet për fazat vijuese të procedurës, ndërsa në kuptim të këtij vendimi më datë 19.07.2023 është publikuar njoftimi për verifikimin paraprak ku në bazë të të cilit ankuesja është përfshirë në listën e ngushtë, si rrjedhojë sipas provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton faktin se më datë 10.08.2023 në orën 13:51 pasdite përmes emailit nga Sh.H, ankuesja në emailin e saj është njoftuar se testi me shkrim mbahet me datë 14.08.2023 nga orë 15:00 në ndërtesën e ish-Rilindjes kati përdhese salla nr. 015, si rezultat i kësaj Kolegji konstaton se emaili i datës 10.08.2023 është dërguar në emailin që ankuesja e ka përkthyer në aplikacionin e saj, ndërsa përmes përgjigjes në ankesë të datës 31.10.2023 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ka njoftuar se të gjithë kandidatët të cilët nuk kanë konfirmuar pranimin e emailit për test, janë kontaktuar edhe përmes telefonit, mirëpo kandidatja në fjalë në aplikacionin e saj nuk ka lënë ndonjë nr. të telefonit, si rezultat i kësaj sipas Kolegjit të këshillit në aplikacionin e ankueses e njëjta nuk ka përkthyer numrin e telefonit me qëllim të kontaktimit në rast të nevojës eventuale për të kontaktuar të njëjtën.

Duke marr parasysh faktin se sipas Vendimit me Nr.23/2023 të datës 19.07.2023 të zv. së Udhëheqëses së Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, ankueses i është aprovuar ankesa, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja ligjërisht nuk ka mundur të parashtrojë ankesë ndaj këtij vendimi, ngase me këtë vendim i është njohur e drejta për përfshirje në listën e ngushtë, mirëpo me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare të kësaj procedure, ankuesja fillimisht është dashur që në pajtim me nenin 25 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual"*, të parashtroj ankesë tek Komisioni i Pranimit e pastaj ka mundur të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtuar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, siç parashihet me nenin 31 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht, duke marr parasysh faktin se kandidatit në procedurë të pranimit nuk i lejohet të parashtroj ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankimit, kështu që pas konstatimit së ankuesja ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa shteruar procedurën e ankesës së brendshme, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se ankesa A.nr.1286/2023 e

datës 13.10.2023, e parashtruar nga ankuesja është e parakohshme.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1286/2023, datë 08/11/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, [REDACTED]
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.